

Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit

Nr, i pro. – 017 / 2016

Data. 14.02.2016

Prizren

Në bazë të kërkesës nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikim Hapësinor, Këshilli për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, jep këtë;

REKOMANDIM

Investitori, **Ardit Jadrashi**, nga Prizreni, me banim në rrugën; " Bajrakliu", nr. 321/2, me të cilën ka kërkuar prej Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor leje për ndërtimin e objektit-shtëpi individuale në ngastrën kadastrale me numër/ 1916-0 ZK-Prizren. **Këshilli nuk e jep pëlqimin për ndërtimin e objektit-shtëpi individuale për shkak të pjerrtësisë së kulmit, që është në kundërshtim me arkitekturën tradicionale të prizrenit si dhe në kundërshtim me planin e konzervimit. Pjerrtësia e kulmin duhet ta ketë një rënie nga 20 deri 30 shkallë maksimum. Si dhe, kulmi nuk guxon ta tejkalon lartësinë 12.5 m nga terreni natyror, dhe straha 9.5 nga terreni natyror. Lartesi e kulmit ne projekt eshte 13.96m, që është në kundërshtim me ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, përkatësisht me nenin 6 (Aktivitetet e kufizuara dhe të ndaluara në Qendren Historike të Prizrenit) e cila percakton me skatesi lartesine maksimale nga terreni natyror (maja u kulmit) 12.5 m dhe streha nga terreni natyror 9.5m.**


Arsyetim

Kërkesa e parashtruar nga investitori për ndërtimin e shtëpisë individuale për banim me lokal afarist, i perket zonës së Qendrës Historike të Prizrenit. Duke u bazuar në Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 6 (aktivitetet e kufizuara dhe te ndaluara ne Qendren Historike te Prizrenit) objekti nuk guxon ta tejkaloje lartesine mbi 12.5 m (kulmi) dhe streha 9.5m nga terreni natyror, si dhe dizajnimi dhe konstruksino i kulmit duhet te jete ne harmoni me arkitekturen tradicionale te Prizrenit, pjerrtesia e kulmit duhet te jete nga 20 deri ne 30 shkalle maksimum.

Anëtarët e keshillit që ishin prezent;

1. Arbno Morina / Anëtar / Kryetar
2. Igballka Rama / Anëtare / Nënkyetare
3. Artnet Haskuka / Anëtare
4. Svetlana Hadzic / Anëtare
5. Faridin Shala / Anëtar

KTK, Pizren



Arbno Morina, Kryetar.

15.03.2016

